




Funded by the
European Union



2022- 2025

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE SI DHE TË KTHYERVE NGA EMIGRIMI DHE AZILI

BASHKIA DEVOLL





Funded by the
European Union



(2022-2025)

**Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e
Pakicave Rome dhe Egjiptiane si dhe të
Kthyerve nga Emigrimi dhe Azili**

BASHKIA DEVOLL

Maj 2022

Tabela e Përmbajtjes

	Shkurtesat	6
01	PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK	8
	Hyrje	9
	Kuadrit legjislativ, politik, rregullator dhe institucional në mbështetje të të kthyerve në Shqipëri	10
	Parimet Themelore të PVVIREKEA (2022-2025)	12
	Metodologjia	13
	Profili i Bashkisë Devoll dhe Administrata	15
	Administrata	16
	Kushtet Aktuale, Problematikat dhe Sfidat	17
02	PJESA II: VIZIONI, MISIONI, QËLLIMET E POLITIKËS	21
	Qëllimet e Politës të PVVIREKEA (2022-2025)	22
03	PJESA III: KUADRI VLERËSUES DHE MONITORUES	23
04	PJESA IV - ANALIZA BUXHETORE	25
05	SHTOJCA:	27
	Matrica e PVVIREKEA (2022-2025)	27
	Buxheti i Detajuar	27
	Grupi i task forces për Bashkinë Devoll	27

SHKURTESAT

AFP	Aftësim dhe Formim Profesional
AKPA	Agjensia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
BE	Bashkimi Europian
DSHSK	Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomise
MK	Ministria e Kulturës
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NE	Ndihme Eknomike
NJMF	Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJVKSH	Njesitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PIV	Plani Individual i Veprimit
PNP	Programe të Nxitjes së Punësimit
PVVIREKEA	Planin Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane si dhe të Kthyerve nga Emigrimi dhe Azili
PBB	Produkt i Brendshem Bruto
QKB	Qendra Kombëtare e Bisnesit
R&E	Romë dhe Egjiptianë
ROMALB	Sistemi i integruar i të dhënave të indikatorëve të Strategjise Kombëtare për Pakicat Rome dhe Egjiptiane
SHQK	Shkolla Qender Komunitare
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZPK	Zyra e Punëkërkesve
ZVA	Zyra Vendore Arsimore
ZVAP	Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar

FALENDERIME

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane si dhe të Kthyerve nga Emigrimi dhe Azili (2022-2025) të Bashkisë Devoll ishte përpjekje e përbashkët e institucioneve publike dhe jo-publike në nivel lokal të lidhura drejtëpërdrejtë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave pakicave Rome dhe Egjiptiane në qytetin e Devollit, duke përfshirë: Bashkinë Devoll, Zyrën e Punësimit, Zyrën Rajonale të Shërbimit Social, Zyrën e Gjendjes Civile, Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Publik, organizatat e shoqërisë civile, organizatat Rome dhe Egjiptiane.

Një falenderim të veçantë do të donim t'iu jepnin anëtarëve të grupit të punës drejtuar nga nënkryetarja e Bashkisë Devoll Znj. Zerina Sinani, të cilët në takimet periodike të organizuara gjatë procesit të hartimit të strategjisë, me mendimet, opinionet dhe diskutimet e tyre kanë dhënë një kontribut tepër të vyer në draftimin e këtij dokumenti.

Gjithashtu, një falenderim i veçantë shkon përfaqësuesve të pakicave Rome dhe Egjiptiane që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e Planit të Veprimit, pa ekspertizën dhe përkushtimin e tyre hartimi i dokumentit do të kishte qenë i pamundur.

Së fundi, nuk mund të lëmë pa falenderuar dhe kontributin e stafit të projektit UNDP titulluar “ Forcimi i sistemeve kombëtare dhe lokale për të mbështetur integrimin efektiv socio-ekonomik të të kthyerve në Ballkanin Perëndimor”; projekt rajonal i financuar nga Komisioni Evropian dhe i zbatuar në koordinim me Bankën Botërore dhe Këshillin e Evropës, të cilët me devotshmëri kanë ofruar asistencën e tyre teknike përmes ekspertëve lokale Znj. Elvana Gadeshi dhe kanë asistuar në mbarëvajtjen e tërë procesit të konsultimit, hartimit dhe finalizimit të këtij dokumenti politik lokal.

PJESA I
KONTEKSTI
STRATEGJIK



HYRJE

Qeverisja e mirë dhe garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm janë në themel të asaj çka qeverisja në çdo nivel duhet të sigurojë për qytetarët. Kjo është veçanërisht sfiduese në nivel vendor ku problematikat e decentralizimit dhe reformimit i janë shtuar atyre të mëhershme. Për këtë nevojitet, ndër të tjera, një përmirësim i vazhdueshëm i menaxhimit të të gjitha burimeve vendore, forcimi i planifikimit strategjik, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, rritja e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendim-marrëse si dhe monitorimi i zbatimit të politikave dhe programeve në nivel vendor mbi bazën e parimit të mosdiskriminimit dhe angazhimit qytetar.

Një instrument i rëndësishëm që e mundëson mirëqeverisjen në nivel vendor janë planet vendore të zhvillimit. Ato përdoren nga bashkitë për të përmirësuar aspekte të qeverisjes vendore në kuadër të zbatimit të politikave të zhvillimit bazuar në vlerësimin e nevojave duke mundësuar shpërndarjen e priorizuar të burimeve të vlefshme, lejon identifikimin e hendekut financiar për të negociuar me aktorë të tjerë dhe agjenci donatore në mbështetje të projekteve të zhvillimit në nivel vendor, si dhe mundëson monitorimin e rregullt të zbatimit të masave dhe aktiviteteve.

Ky dokument paraqet Planin Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane si dhe të Kthyerve nga Emigrimi dhe Azili (2022-2025) të Bashkisë Devoll (këtu e më poshtë PVVIREKEA (2022-2025)), një instrument që do të garantojë që parimet e mirëqeverisjes do të zbatohen dhe mundësojnë integrimin dhe gjithëpërfshirjen e pakicave Rome dhe Egjiptiane në këtë bashki për periudhën 2022-2025. Ky plan vjen si një zhvillim progresiv i Planit Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025.

Në deklaratën e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor mbi Integrimin e Romëve në Procesin e Zgjerimit të BE, Shqipëria bëri një angazhim për të vazhduar dhe rritur përpjekjet për barazi të plotë dhe integrimin e Romëve, veçanërisht përmes zbatimit dhe ndjekjes së Konkluzioneve të Përbashkëta të Seminareve Rome, në sektorët e Punësimit, Strehimit, Arsimit, Shëndetit, Regjistrimit civil, Mbrojtje Sociale dhe Mos-diskriminim. Shqipëria u angazhua për të zhvilluar, miratuar dhe zbatuar standarde rajonale mbi buxhetimin publik në lidhje me integrimin e romëve për politikën e synuara, si dhe rritjen e buxhetit publik (qëndror dhe lokal) për integrimin e këtij komuniteti; të krijojë kanale dhe mekanizma zyrtarë për përfshirjen e përbashkët të vetëqeverisjes vendore dhe komunitetit romë në formulimin e politikave, vendimmarrjes, zbatimit dhe monitorimit të përpjekjeve të ndërmarra për arritjen e objektivave të kësaj Deklarate.

Plani përputhet plotësisht me kornizën e re strategjike rome të BE-së për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje 2020-2030.

Përpjekjet e Bashkisë Devoll dhe organizatave të tjera si dhe të dhënat nga viti i fundit (2021) tregojnë se ekzistojnë ende probleme të regjistrimit civil, arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor, strehimit dhe mbrojtjes sociale. Këto probleme janë edhe më të mëdha kur shtohet stigma sociale aktuale, stereotipet dhe diskriminimi që për fat të keq janë akoma të pranishme ndaj pakicave Rome dhe Egjiptiane.

Financimi për zbatimin e masave të parashikuara në PVVIREKEA (2022-2025), është parashikuar në buxhetin e Bashkisë Devoll, pas një vlerësimi të fondeve të disponueshme. Në rastet kur buxheti i Bashkisë nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e plotë të objektivave, PVVIREKEA (2022-2025) parashikon një ndarje të hendekut të financimit si dhe propozimin për fonde donatorësh. Në përmbushjen e këtij gendeku një rol të rëndësishëm do të luaj Projekti i PNUD “Forcimi i sistemeve kombëtare dhe lokale për të mbështetur integrimin efektiv socio-ekonomik të të kthyerve në Ballkanin Perëndimor”.

KUADRIT LEGJISLATIV, POLITIK, RREGULLATOR DHE INSTITUCIONAL NË MBËSHTETJE TË TË KTHYERVE NË SHQIPËRI

Ky seksion përmbledh/rishikon kuadrin aktual legjislativ, rregullator, politikë dhe institucional që mundëson dhe mbështet riintegrimin e të kthyerve, duke përfshirë edhe pakicat Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri.

Punësimi dhe integrimi i të kthyerve në Shqipëri është në fokus të disa akteve politike dhe legjislative. Dokumentet e tilla të politikave janë renditur më poshtë, por pa u kufizuar në:

- ⊙ Strategjia Kombëtare e Migracionit dhe plani i saj i veprimit 2019 - 2022;
- ⊙ Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2019-2022,
- ⊙ Ligji 9668/2006 “Për emigracionin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi” i ndryshuar në vitin 2011;
- ⊙ Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.
- ⊙ Plan i Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2021 – 2025.

Strategjia Kombëtare e Migracionit 2019-2022 miratuar me VKM nr. 400, datë 19.6.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019-2022”, propozon që për riintegrimin në tregun e punës të emigrantëve të kthyer, nevojitet hartimi i legjislacionit në drejtim të njohjes dhe certifikimit të mësimin në mënyrë formale ose joformale. Masat e riintegritit përfshijnë hartimin dhe publikimin e paketave të informacionit për riintegrimin e të kthyerve, lehtësimin e krijimit të bizneseve të vogla dhe të mesme nga të kthyerit, si dhe kryerjen e një vlerësimi të detajuar të sfidave dhe nevojave specifike të migrantëve të kthyer për një riintegrim të tyre më efektiv në tregun e brendshëm.

Ligji 9668/2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar, përcakton rolet e institucioneve në nivel qendror dhe strukturat në varësi të tyre për të përmbushur detyrimet për riintegrimin e emigrantëve të kthyer.

Në fakt, ky ligj i përkufizon të kthyerit si “shtetas shqiptar i kthyer në Republikën e Shqipërisë, për t’u larguar sërish ose jo, pasi të ketë kaluar të paktën një vit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Emigranti i kthyer është gjithashtu shtetasi shqiptar i kthyer vullnetarisht ose detyrimisht nga vendet pritëse në Republikën e Shqipërisë, për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit dhe kushteve për hyrjen, praninë ose qëndrimin e rregullt në vendet pritëse, në zbatim të marrëveshjeve të ripranimit, duke përfshirë edhe familjarët e tyre.”

Më e rëndësishmja, disa nga detyrimet e këtij ligji për riintegrimin në tregun e punës të emigrantëve të kthyer janë pasqyruar në Ligjin 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, sipas të cilit emigrantët e kthyer që janë “punëkërkuar të papunë, të kthyer nga emigracioni brenda një periudhe prej 2 vitesh” të përfshihen në grupet që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit. I njëjti ligj përcakton se edhe individë nga pakicat Rome dhe Egjiptiane janë përfitues të Programeve të Nxitjes së Punësimit.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive 2019-2022 përcakton Programet Aktive të Tregut të Punës si një mënyrë për të ndihmuar riintegrimin në tregun e punës të punëkërkuarve të papunë të cilët bëjnë pjesë në grupet e disavantazhuara.

Plani i Veprimit NESS kërkon që Qeveria të monitorojë këto politika aktive të tregut të punës në mënyrë që t’i përmirësojë dhe t’i bëjë ato më të synuara dhe efektive. Për të ndihmuar në përputhjen e ofertës së punës me kërkesën, një hartë dixhitale e vendeve të lira të punës synohet të zhvillohet dhe të bëhet funksionale gjatë vitit 2022 në nivel rajonal dhe lokal. Ai do të ketë mbulim në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe do të përditësohet vazhdimisht me të dhëna nga punëdhënësit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe punëkërkuarët. Gjatë vitit 2022 është planifikuar të krijohet edhe një call center, si një mjet përforcues për afrimin e ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore.

Qeveria miratoi në nëntor 2021 Planin Kombëtar të Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e komuniteteve romë dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë 2021 – 2025. Ky dokument politikash përcakton midis disa treguesve që: i) deri në fund të vitit 2025, rreth 60% e punëkërkuarve të papunë romë dhe egjiptianë janë të punësuar, ose janë pjesë e Programeve të Nxitjes së Punësimit, ose kanë konkurruar për Aftësitë dhe Arsimin Profesional; gjithashtu deri në fund të vitit 2025, rreth 12 ndërmjetës romë dhe egjiptianë janë pjesë e Zyrave të Punësimit; ii) deri në fund të vitit 2025 të paktën 300 romë dhe egjiptianë do të kenë marrë mbështetje financiare dhe do të jenë integruar në ekonominë formale; dhe iii) deri në fund të vitit 2025 rreth 70% e romëve dhe egjiptianëve që marrin Asistencë Sociale - Ndihma Ekonomike, kanë dalë nga skema e mbështetjes dhe janë riintegruar në tregun e punës. Në këtë plan përcaktohet qartë që Bashkitë do të duhet të forcojnë përpjekjet e tyre për të mbështetur pakicat Rome dhe Egjiptiane në territoret e tyre, si dhe të përmirësojnë kapacitetet e mbledhjes së të dhënave në nivel lokal.

Krahas dokumenteve të politikave të miratuara deri më tani, Qeveria ka nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi me GIZ-in në fushën e migracionit gjatë viteve të fundit, me fokus lehtësimin e kthimit dhe riintegrimin të migrantëve të kthyer. Aktualisht GIZ në bashkëpunim me AKPA, si institucioni përfitues kryesor, po zbaton programe të cilat kanë në fokus të veçantë kthimin dhe riintegrimin e emigrantëve të kthyer në vendet e tyre të origjinës.

Bashkia Devoll ka Planin e Kujdesit Social të miratuar nga Këshilli Bashkiak por ndërkohë nuk ka patur një plan vendor për riintegrimin e pakicave Rome dhe Egjiptiane.

PARIMET THEMELORE TË PVVIREKEA (2022-2025).

PVVIREKEA (2022-2025) do të udhëhiqet nga disa parime bazë:

1. **Hartimi i politikave konstruktive, pragmatike dhe jo-diskriminues** – Objektivat e përfshira në Planin e Veprimit synojnë përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve dhe realizojnë vlerat thelbësore të Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, mosdiskriminimin dhe barazinë e mundësive, si dhe zhvillimin ekonomik.
2. **Përdorimi i një qasjeje të targetuar/synuar për trajtimin e çështjeve specifike të përjashtimit** – Planin e Veprimit propozon masa të targetuara për përgjigjen ndaj situatave të emergjencës që nuk mund të trajtohen përmes burimeve të përgjithshme.
3. **Nxitja e përfshirjes sociale** – Aktivitetet e PVVIREKEA (2022-2025) synojnë të nxisin përfshirjen e pakicave Rome dhe Egjiptiane në shoqëri e jo të krijojnë sisteme paralele për t'u përdorur nga këto komunitete.
4. **Respektimi i dallimeve** – PVVIREKEA (2022-2025) do të respektojë dallimet mes komunitetit Rom dhe atij Egjiptian, si dhe brenda vetë këtyre komuniteteve. Planin e Veprimit do të trajtojë anëtarët vulnerabël të këtyre komuniteteve, duke njohur faktin që disa romë dhe egjiptianë janë tashmë të integruar në shoqëri.
5. **Vënia e theksit mbi angazhimin e romëve dhe egjiptianëve** – PVVIREKEA (2022-2025) përfshin mekanizmat për angazhimin e pakicave Rome dhe Egjiptiane në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike.
6. **Nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm lokal dhe qendrorë** – Krijimi dhe zbatimi i PVVIREKEA (2022-2025) është bazuar në bashkëpunimin midis qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, komunitetit ndërkombëtar dhe veçanërisht vetë komuniteteve.
7. **Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale** – PVVIREKEA (2022-2025) trajton nevojat në një sërë fushash kyçe, duke përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimi urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë si dhe antixhipsizmin, me synim nxitjen e integritimit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.
8. **Politika bazuar në evidenca dhe matjen e progresit** – PVVIREKEA (2022-2025) është pajisur me tregues për matjen e progresit të zbatimit dhe treguesit fillestarë (nga ku do të nisë puna) kur është e mundur. Zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve të përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve do të krijojë një bazë të mirë të të dhënave socio-ekonomike të cilat do të mblidhen rregullisht.
9. **Ndërgjegjësimi mbi dimensionin gjinor** – PVVIREKEA (2022-2025) pranon faktin se gratë rome dhe egjiptiane kanë më tepër gjasa të vuajnë përjashtimin dhe diskriminimin gjinor. Sidoqoftë, gratë rome gjithashtu kanë një rol thelbësor për të luajtur në promovimin e përfshirjes (p.sh. si ndërmjetës për integrimin e fëmijëve në sistemin arsimor)

10. **Përfshirja e shoqërisë Civile** – Bashkëpunimi me OSHC, partnerë socialë, dhe vetë komunitetet rome është esenciale në këtë plan të ri. Këta aktorë kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e këtij plani dhe do të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij. Organizatat dhe rrjetet rome kanë jo vetëm ekspertizë të vlefshme për të ofruar, por ato gjithashtu do të jenë aktorë të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit tek të tjerët.
11. **Buxhetimi për zbatimin** – Bashkia Devoll ka identifikuar buxhetet përkatëse për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi është i pamjaftueshëm, bashkia ka identifikuar hendeqet e financimit ku mund të kërkohet ndihmë nga donatorë.

METODOLOGJIA

Në bazë të hartimit të PVVIREKEA (2022-2025) qëndron legjislacioni vendas dhe standardet ndërkombëtare të njohura nga Shteti Shqiptar si dhe të gjithë politikat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në kuadër të përfshirjes sociale të pakicave Rome dhe Egjiptiane. Raporte ekzistuese apo dokumenta relevante të përgatitura nga Bashkia Devoll, si dhe të dhëna të mbledhura nga terreni lidhur me situatën aktuale të pakicave Romedhe Egjiptiane në qytetin e Devollit përbëjnë themelet mbi të cilat është hartuar ky dokument.

Ky dokument është në linjë me Strategjinë Kombëtare për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025), Rekomandimet Operacionale që kanë dalë nga Seminari i IV i Dialogut të Politikave (Dhjetor 2018) për përfshirjen e pakicave Rome dhe Egjiptiane në kornizën e procesit të integritimit evropian të Shqipërisë dhe dokumentet tjera strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Hartimi i PVVIREKEA (2022-2025) ka qenë një proces konsultativ dhe gjithëpërfshirës. Ngritja e ekipit të punës, identifikimi i mbështetësve institucionalë dhe takimet prezantuese me ta, i paraprinë analizës së situatës së komunitetit Rom dhe Egjiptian në qytetin e Devollit.

Hartimi i këtij plani vendor veprimi është bazuar në analizën e të dhënave sasiore dhe cilësore, primare dhe sekondare, të mbledhura në zonën e Devollit. Metodologjia kërkimore përfshin: i) diskutime në grupe fokusi me komunitetet vendore rome dhe egjiptiane; ii) intervista gjysmë të strukturuar me aktorë kryesorë si dhe me drejtues formalë dhe jo-formalë në komunitetet rome dhe egjiptiane iii) Të dhëna statistikore të mbledhura nga sistemi elektronik i të dhënave të Planit Kombëtar të Veprimit ROMALB; iv) të dhëna të nxjerra nga dy vlerësime të zhvilluara nga PNUD gjatë periudhës nëntor 2021-janar 2022 respektivisht: a. Vlerësimi i kapaciteteve dhe pengesave institucionale dhe individuale për aksesin në shërbime lokale cilësore nga të kthyerit romë dhe egjiptianë në Bashkitë Berat, Fier dhe Berat; b. Vlerësimi i potencialeve të zhvillimit ekonomik lokal të Bashkive Berat, Fier dhe Berat dhe përcaktimi i perspektivës së furnizimit lokal dhe zinxhirit të vlerës.

Mbledhja e të dhënave është realizuar nëpërmjet punës në terren të ekspertit lokal, bazuar kjo në takimet e drejtëpërdrejta me komunitetin Rom dhe Egjiptian (në takime individuale apo fokus grupe), ashtu dhe në takimeve me aktorë shtetërorë dhe jo- shtetërorë në nivel lokal. Një ndihmë të veçantë në mbledhjen e të dhënave ka dhënë grupi i punës i përbërë nga aktorë të ndryshëm lokal, i ngritur që në fillim të muajit Dhjetor 2021 në Bashkinë Devoll, me qëllim që të asistojë, lehtësojë dhe ofrojë kontributin e tij gjatë tërë procesit të hartimit të Planit Lokal të Veprimit. Ngritja e grupit të punës dhe organizimi i takimeve periodike synuan angazhimin

konkret të aktorëve lokalë dhe rajonalë gjatë të gjithë procesit të hartimit të planit lokal të veprimit. Takimet kanë qenë ndëraktive, dhe janë karakterizuar nga diskutime të vazhdueshme, ndarje idesh dhe opinionesh, bazuar kjo në përvojat eksperiencat konkrete të punës dhe problematikat e hasura gjatë punës së përditshme me pakicat Rome dhe Egjiptiane. Gjatë këtyre takimeve, anëtarët e grupit të punës dhanë kontributin e tyre të drejtpërdrejtë në lidhje me analizën e situatës lidhur me nevojat e komunitetit Rom dhe Egjiptian në qytetin e Devollit, si dhe ide dhe rekomandime konkrete për ndërhyrjet që duhen përfshirë në këtë dokument si dhe mënyrat efektive për t'i vënë në zbatim.

Grupi i punës përbëhet nga institucione si më poshtë:

- ⊙ Nën kryetari i Bashkisë Devoll
- ⊙ Përfaqësues i zyrës së punës pranë Bashkisë Devoll
- ⊙ Administratori në nivel lokal i shërbimit social
- ⊙ Përfaqësues i zyrës së dhunës në familje pranë Bashkisë Devoll
- ⊙ Përfaqësues i zyrës arsimore
- ⊙ Përfaqësues nga OSHC Rome që ndodhen në komunitet
- ⊙ Përfaqësues i zyrës së gjendjes civile pranë Bashkisë Devoll
- ⊙ Përfaqësues nga zyra e strehimit
- ⊙ Përfaqësues nga institucioni i shëndetësisë
- ⊙ Përfaqësues të zgjedhur nga pakicat Rome dhe Egjiptiane

Çdo fushë e identifikuar është adresuar në mënyrë të veçantë duke identifikuar aktivitete të detajuara dhe konkrete, indikatorë, aktorët përgjegjës, mbështetësit si dhe buxhetin e parashikuar dhe burimin e mundshëm nga i cili mund të sigurohet ky buxhet, duke përfshirë pushtetin qendror, pushtetin lokal, donator apo organizata të shoqërisë civile.

Mendimet dhe opinionet e anëtarëve të grupit të punës janë reflektuar në mënyrë të vazhdueshme deri në finalizimin e këtij dokumenti.

Mjaft ndihmëse, gjatë tërë procesit të hartimit të PVVIREKEA (2022-2025), ka qenë konsulta e vazhdueshme nga stafi i projektit të PNUD “ Forcimi i sistemeve kombëtare dhe lokale për të mbështetur integrimin efektiv socio-ekonomik të të kthyerve në Ballkanin Perëndimor”, projekt rajonal i financuar nga Komisioni Evropian dhe i zbatuar në koordinim me Bankën Botërore dhe Këshillin e Evropës, të cilët jo vetëm mundësuan këshillimin e vazhdueshëm të ekspertit në nivel lokal, të kontraktuar për të lehtësuar zhvillimin e këtij plani veprimi, por gjithashtu mundësuan shkëmbimin e eksperiencave me ekspertë të tjerë të përfshirë në hartimin planeve të veprimit, si dhe mësimin nga praktikat më të mira në Rajon në lidhje me hartimin e një plani veprimi të qëndrueshëm, efektiv dhe funksional.

PROFILI I BASHKISË DEVOLL DHE ADMINISTRATA

Bashkia e Devollit ndodhet në juglindje të Shqipërisë dhe mbulon një sipërfaqe prej 453.27 km² kufizuar me katër komuna të tjera, përkatësisht me Pustec, Maliq, Korçë dhe Kolonjë, dhe në lindje është në kufi me Greqinë. Devulli përbëhet nga pesë njësi administrative: Bilisht, Bilisht-Qendrore, Hoçish, Miras dhe Proger. Në fund të vitit 2020, popullsia e bashkisë ishte 41,606 banorë të ndarë në njësitë administrative siç paraqitet në tabelën më poshtë. Sidoqoftë, deri në fund të vitit 2021, të dhënat e marra nga bashkia tregojnë një rënie të popullsisë, në 41,191.

FIGURA 1 HARTA E BASHKISË DEVOLL



TABELA 1 POPULLSIA SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE, BASHKIA DEVOLL

Njësia Administrative	Bilisht	Miras	Proger	Bilisht-Central	Hoçisht	Total
Numri I Banorëve	10,495	9,806	5,926	8.625	6,754	41.606
Gra	5,293	4,710	2,941	42,59	3,325	20,528

(Burimi: Bashkia Devoll, 2021)

Në Bashkinë Devoll ka një komunitet të rëndësishëm Rom dhe Egjiptian, me rreth 520 banorë, shumica e të cilëve jetojnë në qytetin e Bilishtit. Popullsia rome dhe egjiptiane banon kryesisht në njësitë administrative Proger dhe Qendër Bilisht.

Devulli është një ekonomi e vogël në Shqipëri. Struktura e tij ekonomike është e ndryshme nga struktura ekonomike e qarkut të Korçës, pjesë e të cilit është edhe bashkia e Devollit. Qarku i Korçës përbën 5,39% të PBB-së shqiptare. Ajo ka një ekonomi të dominuar nga shërbimet, të cilat përfaqësojnë 42,5% të ekonomisë së rajonit, e ndjekur nga bujqësia me 39,8%, dhe industria dhe ndërtimi, që zënë përkatësisht 9,7% dhe 8%. Sektorët kryesorë ekonomikë të Bashkisë Devoll janë bujqësia dhe shërbimet, ndërkohë që industria është thuajse inekzistente. Kështu, burimi kryesor i punësimit në Bashkinë Devoll është bujqësia, e ndjekur nga shërbimet, ndërkohë që industria është më pak e zhvilluar në këtë pjesë të qarkut të Korçës.

Bashkia e Devollit ka një numër total prej 2,568 ndërmarrjesh të regjistruara në vitin 2020, duke zënë rreth 1.5% të ndërmarrjeve të regjistruara në Shqipëri.

ADMINISTRATA

Këshilli Bashkiak, si organ kolegjal dhe përfaqësues i Bashkisë Devoll , përbëhet nga 21 anëtarë. Numri gjithsej i nëpunësve vendorë të Bashkisë është 380. Administrata publike e Bashkisë përbëhet nga disa struktura (drejtori) kryesore:

- ⊙ Drejtoria e të ardhurave, lejave dhe licensave.
- ⊙ Drejtoria e Planifikimit të territorit, kadastrës, investimeve projekteve dhe integritit.
- ⊙ Drejtoria e Shërbimeve juridike dhe burimeve njerëzore.
- ⊙ Drejtoria e Shërbimeve sociale shëndetsore dhe strehimit .
- ⊙ Drejtoria e Shërbimeve financiare dhe buxhetit .
- ⊙ Agjensia e kultures, arsimit, rinisë dhe sporteve
- ⊙ Agjensia e Shërbimeve utilitare, komunitare dhe administrative
- ⊙ Drejtoria e Inspektimit dhe mbrojtjes së territorit dhe mjedisit
- ⊙ Drejtoria e zhvillimit të pyjeve, bujqësisë, mbrojtjes së tokës dhe konsumatorit

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në vitin 2021 kanë qenë 133,877,749 Lekë. Drejtoria e Shërbimit Social është një strukturë e rëndësishme e Bashkisë, e cila përbëhet nga disa zyra (sektorë) kryesorë: (i) Zyra e Ndhmës Ekonomike dhe Pagesave (6 nëpunës), (ii) Zyra e kujdesit Social dhe PAK (Barazia Gjinore, Mbrojtja e të Drejtave të fëmijëve, Mbrojtja e të Drejtave të pakicave kombetare dhe diskrimimit, PAK) 7 nëpunës. Gjithësej 13 nëpunës.

Stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social ka përfituar nga programe trajnimi në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve për zbatimin e sistemit të ri të ndihmës ekonomike (NE) gjatë viteve 2017-2018, trajnime për shërbimet e integruara, përfshirë edhe menaxhimin dhe përditësimin e sistemit ROMALB. Drejtoria ka nevojë për fuqizim të burimeve njerëzore në disa sektorë shërbimi. Mungon Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (vetëm një nëpunës mbulon të gjithë territorin /njësitë administrative), si dhe ka nevojë për mbështetje për ngritje të kapaciteteve/trajnime në fushën e shërbimit social. Kjo për arsye se mjaft punonjës largohen nga vendet e tyre të punës dhe nëpunësit e rinj kanë nevojë për të forcuar kapacitetet e tyre profesionale.

Fondi vendor i planifikuar për shpenzime të kujdesit social (përfshirë NE) ka qenë në nivelin e 13, 655, 000 Lekë në vitin 2021 për rreth 1,000 familje përfituese.

KUSHTET AKTUALE, PROBLEMATIKAT DHE SFIDAT

Pakicat Rome dhe Egjiptiane dhe të kthyerit nga emigrimi apo azili në Bashkinë Devoll

Në Devoll jetojnë rreth 450 romë dhe 70 egjiptianë. Kjo e bën Devollin të dallohet nga bashkitë e tjera, ku prirja kryesore është se minoriteti egjiptian është më i madh se minoriteti rom. Shumica e familjeve rome jetojnë në Bilisht, në lagjen e njohur si “Cezma e Madhe”; rreth 15 familje banojnë në njësinë administrative Proger dhe vetëm disa të tjera janë të shpërndara në fshatrat e kësaj komune (p.sh. Bitincke, Macurisht, etj.).

Të jesh një Bashki e vogël nuk është e dobishme kur bëhet fjalë për të dhënat për migrimin dhe kthimin. Edhe pse Devolli ka qenë një nga zonat me lëvizshmërinë më të hershme dhe më intensive (edhe për faktin e të qenit një bashki në kufi me Greqinë), mungojnë të dhënat për migrimin dhe kthimin. Çështjet e migrimit dhe kthimit nuk kanë qenë prioritet në të kaluarën përfshirë këtu edhe çështjen e mbledhjes së të dhënave. Kjo konfirmohet nga të dhënat parësore të mbledhura në kuadër të vlerësimit të kryer me mbështetje të PNUD. Bashkia e Devollit nuk mbledh në mënyrë të dedikuar të dhëna për të kthyerit dhe nuk disponon asnjë sistem/procedurë/instrument për identifikimin dhe regjistrimin e të kthyerve dhe nevojat e tyre në procesin e riintegritimit.

Gjatë intervistave dhe diskutimeve të thelluara shpjegohet se në Bashkinë Devoll është e vështirë të bëhet dallimi midis të kthyerve dhe jo të kthyer, pasi shumica e banorëve të zonës kanë migruar dhe kthyer të paktën një here.

Sipas informacioneve kryesore të marra nga Bashkia dhe komuniteti Rom, shumica e familjeve rome kanë përjetuar migrim dhe kthim, dhe një pjesë e mirë lëvizin vazhdimisht brenda ose jashtë për punë. Edhe pse raportohet se kanë provuar dhe kanë dështuar azilkërkimin në vendet e BE-së, shumica e tyre vazhdojnë të emigrojnë për periudha më të shkurtra kohore (mesatarisht 2-3 muaj) në vendet fqinje për punë sezonale. Vendet e migrimit janë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut, për tu punësuar në bujqësi, ose në Kosovë. Gjithashtu migrimi është edhe brenda Shqipërisë kryesisht në Durrës dhe Vlorë gjatë verës duke punësuar kryesisht me punimin (thurjen) e cadrave të plazhit etj. Për shkak të lëvizshmërisë gjatë gjithë vitit, brenda dhe jashtë vendit, ofruesit e shërbimeve pretendojnë se kjo është e vështirë për të gjurmuar lëvizshmërinë e tyre, identifikuar nevojat e tyre, si dhe nga ana tjetër për vete romët dhe egjiptianët të aftë për të ofruar shërbime cilësore dhe respektuar rregullat dhe rregulloret në fuqi.

Nevojat e pakicave Rome dhe Egjiptiane përfshirë edhe të kthyerit

Romët e Bashkisë Devoll janë ndër komunitetet më të cënueshme që përballen me probleme të shumta dhe të mbivendosura, duke filluar nga varfëria e deri tek përjashtimi social. Në vijim është një përmbledhje e problemeve dhe nevojave kryesore të romëve përfshirë edhe të kthyerit të identifikuar nga: takimet konsultative; të dhënave dytësore të ofruara nga institucionet e nivelit vendor; si dhe të dhënave parësore të mbledhura nga ofruesit e shërbimeve dhe anëtarët e komunitetit Rom në Devoll.

Nevojat/problemet kryesore të të kthyerve romë lidhen kryesisht me varfërinë dhe papunësisë, kushtet e këqija të strehimit, përjashtimi dhe riintegrimi social si dhe arsimit.

Varfëria dhe cilësia e dobët e jetës

Mungojnë të dhënat për nivelin e varfërisë dhe papunësisë për pakicat Rome dhe Egjiptiane. Megjithatë, duke gjykuar nga skema e NE dhe informacioni që administratorët socialë ofrojnë për familjet në njësitë e tyre administrative, sigurisht që mund të konfirmohet se varfëria është një faktor kyç dhe themelor për shumë prej nevojave të familjeve rome dhe egjiptiane, përfshirë të kthyerit. Në përgjithësi, më shumë se 1000 familje kanë qenë në skemën e NE gjatë vitit 2020 dhe rreth 200 të tjera kanë përfituar gjatë vitit 2021. Numri i familjeve rome në skemë është rritur gjithashtu nga 40 familje në vitin 2020, në 50 në vitin 2021, duke konfirmuar një tendencë të vazhdueshme të mbipërfaqësimit të familjeve rome mes familjeve pa të ardhura. Më shumë familje rome mund të kenë nevojë për një mbështetje të tillë, por për shkak të lëvizshmërisë/migrimit dhe/ose mospërputhjes me kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm, ato mbeten jashtë skemës. Shqetësim mbeten vështirësitë me të cilat përballen shumë romë në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm (për shkak të mungesës së arsimimit dhe njohurive të dobëta) dhe në ndjekjen e procedurave të kërkuara.

Arsimi dhe aftësitë për punë tek romët janë në një nivel të ulët si dhe papunësia është e lartë (edhe pse përsëri mungojnë shifrat e sakta). Pjesa më e madhe e familjeve rome, të vendosura në Bilisht, nuk përfituan asnjë tokë të punueshme (në kuadër të ligjit mbi token nr. 7501), gjë që i bëri ato të përballen me vështirësi ekonomike që herët, pas ndryshimeve drastike pas viteve 1990. Raportohet se shumica e familjeve në zonat rurale e kanë shitur tashmë tokën dhe aktualisht po përballen me situata të ngjashme. Familjet rome në Macurisht përmenden të jenë ndër ato që përballen me varfëri ekstreme.

Mundësitë e punësimit në Devoll janë të kufizuara. Megjithatë Zyra Vendore e Punësimit raporton se u jep përparësi të kthyerve dhe romëve, duke ofruar shërbime ndërmjetësi, këshillimi për karrierë, informacion dhe orientim etj. Deri në fund të vitit 2021, Zyra e Punësimit Devoll raportoi se romët janë rreth 13 % e përfituesve të tyre për vitin 2021 dhe mesatarisht 17% në pesë vitet e fundit. Të dhënat për të kthyerit nuk janë mbledhur, për rrjedhojë nuk ka asnjë të kthyer të identifikuar si punëkërkues.

Nga 1,049 punëkërkues të regjistruar në nivel Bashkie, 117 janë identifikuar nga pakicat Rome dhe Egjiptiane. Këta të fundit përbëjnë më shumë se 11% të punëkërkuesve në krahasim me 1.2% të popullsisë së përgjithshme të Bashkisë Devoll. Më shumë romë meshkuj kërkojnë punë përmes shërbimeve të Zyrës së Punësimit. Oferta e punësimit është shumë e ulët. Kjo ofertë e kufizuar i bën ata të synojnë edhe opsione të tjera sic janë: migrim apo punësim në sektorin publik. Ky i fundit është gjithashtu shumë i kufizuar pasi Devolli, duke qenë një bashki e vogël, ka një kapacitet prej vetëm 89 punonjësish në sektorin e Shërbimeve Publike, duke e lënë në këtë mënyrë migrimin si opsionin e vetëm të zbatueshëm.

Strehimi

Çështjet e papunësisë dhe strehimit janë më të rëndësishmet dhe ende të pazgjidhura për komunitetin Rom. Shumë romë jetojnë në shtëpitë e prindërve të tyre, por disa nga familjet jetojnë në banesa me kushte shumë të këqija. Bashkia ndihmon familjet në nevojë për strehim përmes skemës 'Bonusi i Qirasë'. Gjatë vitit 2021, familjet rome përbënin 1/3 e përfituesve (10 nga 30 familje që përfitonin bonus). Nga mënyra se si është hartuar skema, e bën të pamundur përfitimin e bonusit të qirasë për familjet më të rrezikuara dhe më të varfra. Si rezultat, stafi i Bashkisë raporton se kërkesat për strehim janë më të shpeshta dhe më të vështira për t'u adresuar. Në dokumentin e Planit Social 2021-2024, përmendet se Bashkia

Devoll po planifikon të iniciojë një skemë hipotekore në bashkëpunim me bankat dytësore që operojnë në Bashkinë Devoll.

Arsimi

Niveli arsimor dhe aksesimi në shërbim cilësor për fëmijët e romëve (të kthyerit) është një shqetësim kryesor. Nevoja për arsimim më të mirë është e përhapur në të gjitha grupmoshat e pakicës romë. Të rriturit të cilët janë të pa arsimuar e kanë të vështirë të përfshihen në kurset e formimit profesional të cilat kërkojnë një nivel të caktuar arsimimi. Varfëria dhe lëvizshmëria janë faktorët kryesorë që fëmijët e komunitetit Romë të kenë akses të kufizuar në arsim si dhe në raste të tjera të kenë performancë të dobët në arsimimin e tyre.

Regjistrimi i hershëm është shumë i rëndësishëm për një fillim të sigurt në arsim. Në nivel bashkie, raportohet se 13 fëmijë romë dhe egjiptianë ndjekin kopshtin në Bilisht dhe 3 fëmijë kopshtin e Bitinckës, por nuk është identifikuar/raportuar asnjë i kthyer. Për sa i përket nivelit të arsimit të detyrueshëm, Zyra Vendore Arsimore raporton gjithsej 75 fëmijë romë dhe 18 egjiptianë të regjistruar për vitin akademik 2021-2022, duke përfshirë 2 romë të kthyer dhe një egjiptian. Në diskutimet gjatë takimeve konsultative, u evidentua fakti se jo të gjithë fëmijët e regjistruar ndjekin shkollën rregullisht (për shkak të varfërisë, largësisë nga shkolla etj.). Shumë prej tyre kanë performancë të dobët akademike dhe kanë nevojë për mbështetje për të kapërcyer barrierat gjuhësore dhe sfida dhe vështirësi të tjera. Pandemia e Covid-19, kufizimet dhe alternimet e mësimi fizikisht dhe në distancë kanë ngadalësuar disa nga përparimet e arritura. Të vetmit të diplomuar që i përkasin komunitetit rom raportohet se janë të papunë.

Riintegrimi social

Riintegrimi pas kthimit është po aq i vështirë. Kjo për arsye të mungesës së shërbimeve psikosociale për të mbështetur përshtatjen dhe riintegrimin pas kthimit. Megjithatë, është e vështirë të llogaritet/përcaktohet sasia e nevojave të tilla.

Shëndeti

Varfëria, kushtet e këqija të strehimit dhe aksesimi i dobët në shërbimin dhe informacionin e kujdesit shëndetësor rezultojnë në një nivel të ulët të shëndetit dhe mirëqenies për minoritetin Rom. Disa familje romë jetojnë me të ardhurat nga sigurimi i kujdesit afatgjatë për anëtarët e sëmurë (kronikë) të familjes ose ata me aftësi të kufizuara. Kjo përkeqëson perspektivën për punësim dhe përmirësimin e statusit ekonomik. Këto familje mbijetojnë nga përfitimet për ofruesit e aftësisë së kufizuar dhe të kujdesit ose nga dërgesat e anëtarëve të tjerë të familjes që migrojnë.

Romët e kthyer dhe ofrimi i shërbimeve:

Bashkia e Devollit është e vogël dhe me kapacitete të kufizuara. Gjithsesi, ka disa shërbime të ofruara në nivel vendor nga Sektori i Kujdesit Social të Bashkisë, si dhe nga aktorë të tjerë që veprojnë në nivel lokal, nga të cilat mund të përfitojnë romët dhe të kthyerit.

Krahas skemave me para në dorë (NE, invaliditeti, bonus qiraje për banesa), Bashkia Devoll po zhvillon shërbimet e saj komunitare. Veçanërisht për shkak të pandemisë, bashkia është përfshirë në ngritjen e të ashtuquajturave “grupe patronazhi” me gjithsej 65 ofrues shërbimesh, të cilët janë angazhuar në shpërndarjen e pakove ushqimore, identifikimin dhe mbështetjen e të moshuarve që jetonin vetëm, si dhe ofrojnë mbështetje për familjet më në nevojë dhe në nevojë.

Zyra e Punësimit në Devoll ofron shërbime ndërmjetësimi, këshillim karriere dhe shërbime informacioni dhe orientimi. Në Devoll ka një spital dhe 56 qendra shëndetësore dhe gjithsej 13 mjekë të përgjithshëm dhe 56 infermierë mbulojnë të gjithë popullsinë e Devollit. Gjithsej 27 shkolla 9-vjeçare dhe 5 shkolla të mesme ofrojnë shërbime arsimore për rreth 2800 fëmijë. Megjithatë, vetëm një psikolog ofron shërbime psikosociale për fëmijët në të gjithë Bashkinë.

Ndërkohë që romët dhe egjiptianët figurojnë ndër grupet më me prioritet në Bashkinë Devoll, për disa nga shërbimet, si bonus strehimi, shërbime punësimi etj., të kthyerit nuk konsiderohen si kategori ekskluzive. Prandaj, pak dihet për sa i përket nivelit të aksesit dhe përdorimit të shërbimeve nga të kthyerit (romët).

Në përpjekjet për të zgjeruar dhe përmirësuar shërbimet e saj, Bashkia Devoll është asistuar nga OSHC lokale. Nisma ARSIS (2017 – 2020) ofron mbështetje financiare për procedurat ligjore, furnizime me ilaçe dhe ushqime për fëmijët dhe familjet në nevojë, orët passhkollore, mbulimin e tarifave parashkollore etj., dhe duke i dhënë përparësi pakicës Rome. Romët dhe Egjiptianët janë prioritetuar edhe në ndërhyrjet e CRCA (2020-2021) për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen e shkollimit të fëmijëve. Linja e Keshillimit për Gra dhe Vajzë (2020 – 2021) u ka ofruar shërbime viktimave të dhunës në familje dhe Kisha Françeskane vazhdon të mbështesë fëmijët në nevojë, veçanërisht ata nga pakica Rome. PNUD-i në Shqipëri është i vetmi që i afrohet kësaj bashkie me një interes specifik fokusuar tek të kthyerit (romët).

PJESA II
VIZIONI,
MISIONI,
QËLLIMET E
POLITIKËS



VIZIONI

Krijimi i kushteve të përshtatshme për të arritur barazinë, pjesëmarrjen dhe përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane dhe të kthyerve nga emigrimi dhe azili në Bashkinë Devoll, në të gjitha aspektet e jetës shoqërore vecanërisht qasjen në arsim, punësim, strehim, shërbime shëndetësore dhe sociale, për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mirëqënien, si dhe të zvogëloj hendekun social - ekonomik dhe kulturor ndërmjet romëve dhe egjiptianëve nga njëra anë dhe pjesës tjetër të shoqërisë.

MISIONI

Bashkia Devoll merr përsipër obligimin që gjatë periudhës 2022-2025 të sigurojë përfshirjen sociale, ekonomike dhe kulturore të pakicave rome dhe egjiptiane dhe të kthyerve nga emigrimi apo azili në këtë bashki nëpërmjet përcaktimit të prioriteteve strategjike dhe duke zbatuar politika të integruara afatgjatë dhe afatmesme në fushat e aksesit në drejtësi, arsimin dhe kulturës, punësimin, strehimin, mbrojtjes sociale, dhe antixhipsizmit duke respektuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, në përputhje me standartet ndërkombëtare, dhe në kuadër të zbatimit të konventave dhe kuadrit ligjor për respektimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave .

QËLLIMET E POLITËS TË PVVIREKEA (2022-2025)

1. Fuqizimi ekonomik i pakicave Rome dhe Egjiptiane përfshirë edhe R&E të kthyer nga emigrimi dhe azili në Bashkinë Devoll, përmes integritit dhe harmonizimit të ndërhyrjeve për kualifikime dhe punësim.
2. Përmirësimi i situatës arsimore të pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe familjeve të kthyer nga emigrimi në Bashkinë Devoll.
3. Përmirësimi i gjendjes së vendbanimeve të pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe familjeve të kthyer nga emigrimi dhe azili në Bashkinë Devoll.
4. Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe të kthyerve nga emigrimi dhe azili në Bashkinë Devoll.
5. Anëtarë të pakicave Rome dhe Egjiptiane, përfshirë edhe të kthyer nga emigrimi apo azili, përfitojnë programe të përmirësuar të mbrojtjes sociale.
6. Romët dhe Egjiptianët janë të regjistruar dhe kanë akses në shërbimet e gjendjes civile dhe në ndihmën ligjore falas .
7. Garantimi i komunitetit të çliruar nga diskriminimi ndaj pakicave rome dhe egjiptiane që banojnë në Bashkinë Devoll.

PJESA III
KUADRI
VLERËSUES DHE
MONITORUES



Monitorimi i rregullt i zbatimit të PVVIREKEA (2022-2025) në intervale të caktuara kohore, grumbullimi i të dhënave të treguesve të matshëm dhe vlerësimi i impaktit në përmirësimin e aksesit në shërbimet publike të ofruara për komunitetet si dhe publikimi i rezultateve të zbatimit të masave është një përgjegjësi institucionale e bashkisë dhe që bazohet në parimet e besueshmërisë së qeverisjes vendore, mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve dhe informimit publik.

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të ushqejnë orientimin e politikave të reja dhe parashikimin e burimeve në nivel vendor në kuadër të planifikimit strategjik dhe procesit të vendimmarrjes vendore. Gjithashtu raportet e monitorimit do të ofrojnë informacion të vlefshëm dhe cilësor në kuadër të raportimit të sistemit ROMALB, që kryhet dy herë në vit pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në nivel të lartë, raporti i monitorimit do të lehtësojë vendimmarrjen në nivel vendor, i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin e progresit të të gjitha planeve të zhvillimit të miratuara nga Bashkia, si Planin e Përgjithshëm Vendor, procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe buxhetin vjetor. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave/aktiviteteve të këtij plani do të paraqitet në mënyrë periodike (të paktën 1 herë në vit).

Në nivel operacional, për monitorimin e zbatimit të PVVIREKEA (2022-2025) në Bashkinë Devoll, struktura përgjegjëse do të jetë DSHSK. Kjo strukturë është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore nga të gjitha strukturat e Bashkisë sipas sektorëve përkatës si dhe nga të gjitha institucionet e tjera publike. DSHSK në Bashki ka rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit të planit. PVVIREKEA (2022-2025) parashikon publikimin e raporteve vjetore të progresit dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile.

Sfida për një funksionim më të plotë të kuadrit monitorues mbetet rritja e kapaciteteve të vetë stafit të bashkisë, përmirësimi i shkallës së përgjegjshmërisë të strukturave të tjera të bashkisë si dhe bashkëpunimi dhe ndërveprimi me strukturat e tjera të nivelit vendor në varësi të institucioneve qendrore.

Për këtë qëllim nevojitet ngritja e kapaciteteve për të garantuar që të gjitha zyrat publike përkatëse të mund të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të PVVIREKEA (2022-2025), duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë së romëve dhe egjiptianëve.

Në nivel të sektorëve prioritarë dhe të objektivave strategjike, monitorimi do të kryhet përmes mekanizmit të vlerësimit bazuar në rezultate nëpërmjet treguesve të matshëm, si dhe vëzhgimit mbi cilësinë dhe aksesueshmërinë në shërbimet publike të romëve dhe egjiptianëve. Këto vëzhgime vjetore duhet të ndërmerren nga bashkia në bashkëpunim me organizata komunitare dhe OSHCtë lokale. Rezultatet e vëzhgimeve duhet të publikohen në faqen e internetit të Bashkisë dhe reflektohen në sistemin ROMALB.

Në kushtet e burimeve të kufizuara të stafit të bashkisë si dhe kapaciteteve profesionale, monitorimi mund të mbështetet me ekspertizë të jashtme nga projekte të agjencive donatore, të paktën për vitin e parë në procesin e realizimit të monitorimit. Ekspertiza e jashtme do të ndihmojë në zhvillimin e njohurive dhe përmirësimin e kapaciteteve të administratës vendore në drejtim të monitorimit dhe raportimit.

Gjithashtu Bashkia Devoll përditëson rregullisht të dhënat në sistemin elektronik online "ROMALB" për regjistrimin dhe rifreskimin e të dhënave për treguesit e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025) dhe MSHMS ofron asistencë teknike dhe trajnime për përdoruesit e këtij sistemi në Bashki.

PJESA IV
ANALIZA
BUXHETORE



Ky kapitull paraqet shpërndarjen e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të PVVIREKEA (2022-2025). Efektet financiare janë përllogaritur për çdo aktivitetet të Planin e Veprimit, duke mbajtur në konsideratë produktet dhe treguesit e përcaktuar për çdo aktivitet. Efektet financiare parashikohen të përballohen nga buxhetet respektive vjetore të Bashkisë Devoll të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucionet e qeverisë Qëndrore.

Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin me departamentin e financës pranë Bashkisë Devoll. PVVIREKEA (2022-2025). shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e është **103,525,240.00 Lekë**, ose **841,668.62 Euro**. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 123 lek për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit përgjatë 4 viteve të zbatimit të PVVIREKEA (2022-2025).

